


Italia është ndalesa
e parë e

CULTURALB



“Culturalb” – Kultura Shqiptare Udhëton Botën

U prezantua projekti më i ri për promovimin e kulturës shqiptare në botë, “Culturalb” – Kultura Shqiptare Udhëton Botën, një nismë zyrtare e qeverisë shqiptare që synon ta bëjë trashëgiminë dhe krijimtarinë bashkëkohore shqiptare pjesë të dialogut kulturor ndërkombëtar. Përmes një kalendari të pasur me ekspozita, shfaqje, diskutime dhe ngjarje kulturore në qytete të ndryshme të botës, “Culturalb” bën të mundur që kultura shqiptare të udhëtojë, të bashkëbisedojë dhe të ndërveprojë me kultura të tjera. Me “Culturalb”, arti dhe kultura shqiptare nuk kanë kufij!

VIZITA E MINISTRES GONXHJA DHE KRYEMINISTRIT RAMA NË KANTIERIN E QENDRËS SË RE KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË



Ministri Gonxhja, së bashku me kryeministrin Edi Rama, vizituan kantierin e Qendrës së re Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, pranë Parkut të Madh të Liqenit, një institucion i rëndësishëm arti që konsiderohet si më i madhi në Ballkan. Ky qendër do të ofrojë kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore dhe kurseve në artet skenike dhe pamore, si aktrim, balet dhe kërcim, muzikë, pikturë, skulpturë dhe arte digjitale. Përmes kësaj infrastrukture moderne, qytetit do t’i shtohet një skenë e dyfishtë – njëra brenda godinës dhe tjetra jashtë saj në formën e një amfiteatri të hapur në natyrë.

BONUSI I PRANVERËS PËR PENSIONISTËT: 573,965 PËRFITUES DHE 4.9 MILIONË LEKË TË TËRHEQURA

Bonusi i Pranverës për Pensionistët ka përfshirë 573,965 përfitues, të cilët kanë tërhequr gjithsej 4.9 miliardë lekë gjatë muajit mars. Ky bonus është shpërndarë në masën 10,000 lekë për pensionet bazë deri në 20,000 lekë dhe 5,000 lekë për pensionet mbi 20,000 lekë. Përfituesit mund ta tërheqin këtë bonus deri më 30 Shtator 2025, pranë çdo pike të Postës Shqiptare apo në Bankat e Nivelit të Dytë.



TRANSFORMIMI I MOZAIKUT TË TIRANËS NË NJË QENDËR KULTURORE MODERNE



Në Mozaikun e Tiranës, Ministri Gonxhja së bashku me kryeministrin Edi Rama kanë prezantuar transformimin e plotë të këtij monumenti dikur “të heshtur” të trashëgimisë kulturore, i cili tani është kthyer në një hapësirë moderne dhe funksionale. Mozaiku i Tiranës do të shërbejë si një platformë për prezantimin e mozaikëve më të rëndësishëm dhe si një destinacion kulturor i veçantë për qytetin. Në kushte optimale konservimi dhe me programe edukative të dedikuara për fëmijët dhe të rinjtë, kjo qendër e re kulturore synon të ofrojë një dritare bashkëkohore për interpretimin e trashëgimisë arkeologjike shqiptare.

HAPJA E HANGARIT TË ARTIT DHE MBËSHTETJA PËR SKENËN E PAVARUR ARTISTIKE

Kinostudio është gjallëruar sërish me hapjen e Hangarit të Artit, një hapësirë e re krijuese në zemër të vizionit të ri kulturor, ku MEKI prezantoi mbështetjen e zgjeruar për skenën e pavarur artistike, përmes një buxheti të rritur me 45%, 3 milionë euro për projekte, dhe 3,500 evente kulturore të planifikuara për vitin 2025. Ky event bashkoi artistët, institucionet dhe partnerët për të prezantuar arritjet e deritanishme dhe nisjen e nismave të reja si Java Kulturore Ndërkombëtare “CulturAlb” dhe Programi Kombëtar i Granteve për Kulturën dhe Krijimtarinë.



Durana Tech Park: Epiqendra e Rritjes së Sipërmarrjeve dhe Zhvillimit Teknologjik në Rajon

Durana Tech Park shënon fillimin e një tjetër historie suksesi në kuadër të Revolucionit Digjital, duke u kthyer në epiqendrën e re të rritjes së sipërmarrjeve dhe zhvillimit teknologjik në rajon. Ministri Gonxhja, kryeministri Edi Rama dhe drejtoresha e AIC Elira Kokona ndanë certifikatat për rezidentët e parë të këtij parku, që simbolizon një transformim ekonomik ku punësimi dhe krijimi i vlerës ndodhin virtualisht, pa nevojë për prezencë fizike, duke sjellë punë dhe të ardhura nga bashkëpunimet globale, drejtpërdrejt nga Shqipëria për tregun botëror.



Transformimi i Sektorit të Banesave në Vlorë: 150 Familje në Kushte Dinjitoze

Në Vlorë, 150 familje janë strehuar në kushte dinjitoze falë bashkëpunimit mes Bashkisë, Entit Kombëtar të Banesave dhe me mbështetjen e MEKI-t, si pjesë e një transformimi të madh në sektorin e banesave. Investimet strategjike në banesa me kosto të ulët dhe standarde të larta ndërtimi po krijojnë jo vetëm çati, por edhe mundësi për një jetë më të sigurt dhe të qëndrueshme. Gjatë inspektimit të punimeve në pallatet e reja dhe bashkëbisedimit me qytetarët, u evidentua ndryshimi i madh nga ndërtimet modeste të së shkuarës në godinat moderne të sotme, ku qytetari është në qendër të çdo investimi.

SHQIPËRI-LETONI, PARAFIRMOSET MARRËVESHJA KUADËR PËR SIGURIMET SHOQËRORE



Shqipëria dhe Letonia parafirmosën sot Marrëveshjen Kuadër në fushën e sigurimeve shoqërore, e cila ofron përfitime të rëndësishme për qytetarët shqiptarë si pensioni i pleqërisë, familjar dhe ai i invaliditetit. Marrëveshja, e nënshkruar nga zv. ministria Olta Manjani dhe përfaqësuesja letoneze Daina Fromholde, garanton bashkimin e periudhave kontributive, duke mundësuar ruajtjen e viteve të punës dhe përfitimin nga sigurimet në të dyja vendet. Raundi i parë i negociatave u mbajt në Tiranë nga 1-3 prill 2025.

CEREMONIA E HAPJES SË MATCH-MAKER ALBANIA: NXITJA E INVESTIMEVE DHE BASHKËPUNIMEVE NDËRKOMBËTARE

Më 27 mars 2025, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, u zhvillua ceremonia zyrtare e hapjes së Match-Maker Albania, një event i rëndësishëm për nxitjen e investimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare. Në praninë e znj. Laura Saro, drejtoreshë ekzekutive e AIDA-s, ministrit Blend Gonxhja dhe kryeministrit Edi Rama, u theksuan mundësitë e reja të investimeve, zhvillimi i sektorëve strategjikë dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar për një ekonomi të qëndrueshme dhe inovative. Ky event solli ide, mundësi dhe partneritete të reja për të ardhmen e biznesit në Shqipëri dhe rajon.




TAKIMI I PARË I KOMITETIT TË PËRBASHKËT KONSULTATIV ME KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN

U zhvillua Takimi i parë i Komitetit të Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama, Presidentit të KESE Oliver Röpke, Ambasadorit të BE-së Silvio Gonzato, ministreve Majlinda Dhuka dhe Delina Ibrahimaj, si dhe përfaqësuesve shqiptarë e evropianë. Ky komitet, me përbërje të barabartë dhe drejtim të përbashkët, synon të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes partnerëve socialë dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri dhe BE, duke kontribuar në procesin e Stabilizim-Asociimit. Drejtimi dhe organizimi i këtij procesi m'u besua mua si Zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, së bashku me ekipin e përkushtuar të MEKI-t.



FLUKSI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE ARRIN REKORD: €1.6 MILIARDË NË 2024



Fluksi i investimeve të huaja direkte ka arritur në €1.6 miliardë, duke shënuar një nivel rekord dhe një rritje prej €84 milionë (+5.6%) krahasuar me vitin 2023. Turqia kryeson si investitori më i madh me 16.2% të totalit, ndërsa sektori që tërheq më shumë investime është ai i pasurive të paluajtshme, me 24% të fluksit. Edhe stoku i investimeve ka arritur një rekord prej €15.4 miliardë, me një rritje vjetore prej €2.2 miliardë (+16.2%).

SIMPOZIUMI INDUSTRINË KRIJUESE: BASHKËPUNIMIT DYPALËSH

BAVAREZ-SHQIPTAR PËR FORCIMI I



Në Mynih u zhvillua Simpoziumi Bavarez-Shqiptar për Industrinë Krijuese, ku Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit e Republikës së Shqipërisë mori pjesë në përfaqësim zyrtar. Gjatë aktivitetit u zhvilluan takime me z. Eric Beißwenger, Ministër i Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare, z. Bertram Brossardt, Drejtor Ekzekutiv, dhe z. Klaus Josef Lutz, President i Shoqatës së Industrisë Bavareze. Ky simpozium shënoi një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e industrive krijuese, zhvillimit ekonomik dhe mbështetjes për procesin e integritit evropian të Shqipërisë.

NJË HAP I RËNDËSISHËM DREJT ANËTARËSIMIT NË BE, SHQIPËRIA HAP NEGOCIATAT PËR GRUP-KAPITULLIN 2

Në Konferencën e Katërt Ndërqeveritare të mbajtur në Luksemburg, Shqipëria hapi negociatat për Grup-Kapitullin 2 – Tregu i Përbashkët, që përfshin 9 kapituj kyç për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Shtatë prej tyre negociohen nën udhëheqjen e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Në këtë proces ishin të pranishëm katër Zëvendësministra të MEKI-t: Olta Manjani, Blerta Rama, Sokol Duma dhe Enkelejd Musabelliu, pjesë e skuadrës kombëtare negociuese. Ky moment thekson përkushtimin e Shqipërisë për reforma dhe përafrim me legjislacionin e BE-së, duke e afruar vendin më pranë anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian.



VILA 31 X ART EXPLORA – NGA SIMBOL I IZOLIMIT NË QENDËR ARTI DHE DIALOGU KULTUROR

Ish-rezidenca e një epoke të errët, Vila 31, është shndërruar në një hapësirë të re kreative përmes bashkëpunimit me Art Explora. Artistë nga Franca, Tunizia, Libani, Malta, Italia dhe vende të tjera kanë nisur rezidencën e tyre, duke sjellë një program të pasur me performanca, diskutime, punëtori, lexime dhe shfaqje filmash – ambjentet ishin të hapura për të gjithë qytetarët nga 9 deri më 13 prill, me hyrje të lirë.



BASHKËBISEDIMI MBI POLITIKAT E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL

Në ambientet e Tirana Industrial Park, u zhvillua një bashkëbisedim i rëndësishëm me pjesëmarrjen dhe të Kryeministrit Rama, përfaqësuesve të bizneseve dhe punonjësve, mbi strategjinë dhe politikat e punësimit dhe aftësisimit profesional. Në një treg pune në ndryshim të shpejtë, të ndikuar nga zhvillimet teknologjike, u theksua rëndësia e arsimit dhe formimit profesional si rruga më e sigurt dhe efektive drejt punësimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.





TIRANË, HAPET EDICIONI I KATËRT I JAVËVE KULTURORE NDËRKOMBËTARE

Tirana u rikthye në qendër të vëmendjes kulturore me nisjen e sezonit të katërt të Javëve Kulturore Ndërkombëtare – një edicion i ri, plot risi, që do të shndërrojë Shqipërinë në një pikëtakim të kulturave nga e gjithë bota për muaj me radhë. Me një program të pasur artistik dhe shtete të reja pjesëmarrëse, JKN 2025 forcon pozicionin e saj si një platformë kyçe për kulturën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Këtë vit, Tirana mban edhe titullin Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, duke i dhënë ngjarjes një dimension të ri. Një festë gjithëpërfshirëse që promovon artin, diversitetin dhe dialogun ndërkulturor.

ROMË – FIRMOSET MARRËVESHJA ADMINISTRATIVE PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR PENSIONET ME ITALINË

Në një takim të posaçëm në Romë, zëvendësministërja e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Olta Manjani, dhe Ministërja italiane e Punës dhe Politikave Sociale, znj. Marina Calderone, nënshkruan marrëveshjen administrative që i hap rrugë zbatimit të marrëveshjes kuadër për pensionet mes Shqipërisë dhe Italisë. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në qershor 2025, duke sjellë përfitime konkrete për qytetarët shqiptarë që kanë punuar në të dyja vendet.



SHQIPËRIA SHËNON REKORD HISTORIK – PAPUNËSIA BIE NË 8.8%



Papunësia për grupmoshën 15+ ka zbritur në 8.8%, niveli më i ulët i regjistruar ndonjëherë në vend! Ky rezultat pasqyron efektin e reformave të qëndrueshme për punësim, mbështetjes për të rinjtë, gratë dhe grupet në nevojë, si dhe forcimit të arsimit dhe formimit profesional. Një treg pune më gjithëpërfshirës është objektivi ynë i përbashkët – vazhdojmë përpara me vendosmëri!

TIRANË – SHQIPËRIA, LIDERE RAJONALE NË PËRDORIMIN E AI NË SHËRBIMET PUBLIKE DIGJITALE



Me mbi 95% të shërbimeve publike të ofruara online dhe me integrimin e inteligjencës artificiale në administratë, Shqipëria po konsolidohet si një shembull rajonal i transformimit digjital. Nga një vizion në një realitet të prekshëm, modeli shqiptar i shërbimeve publike vendos qytetarin në qendër dhe ndërton një administratë moderne, efikase dhe të orientuar drejt inovacionit – një rrugëtim drejt së ardhmes, ku teknologjia është çelësi i zhvillimit.

BURREL – TAKIM MBI PAKETAT SOCIALE TË QEVERISË SHQIPTARE



Zëvendësministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Enkelejd Musabelliu, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu, diskutuan në Burrel mbi Paketat Sociale që Qeveria Shqiptare ofron për çdo qytetar, me fokus te grupet më të ndjeshme, si fëmijët me aftësi ndryshe, gratë, të rinjtë dhe të moshuarit. Paketat përfshijnë kujdesin shëndetësor, strehimin social, mbështetje për punësim dhe bonuset speciale për këto kategori.

ARRITJE HISTORIKE E PAGËS MESATARE NË SHQIPËRI – 830 EURO NË VITIN 2024

Paga mesatare në Shqipëri ka arritur në 830 euro në vitin 2024, nga vetëm 322 euro në vitin 2013 – një progres i ndjeshëm që pasqyron zhvillimin e vazhdueshëm të tregut të punës. Kjo arritje është rezultat i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2030, e cila synon ndërtimin e një tregu pune më dinjitoz, të mirëpaguar dhe të orientuar drejt aftësive.

DURRËS – RESTAURIMI I MUZEUT ARKEOLOGJIK, NJË THESARI I HISTORISË SHQIPTARE

Ministri i Kulturës, z. Gonxhja, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe Kryetaren e Bashkisë Durrës, Emiriana Sako, vizituan Muzeun Arkeologjik, i cili po rilind nga e para pas një kalvari të gjatë tentativash dhe projekteve të pasuksesshme. Muzeu, që përmban mbi 2400 objekte të rëndësishme të historisë sonë antike, do të rinovohet plotësisht me pavione të reja, ndriçim dhe kushte bashkëkohore. Përfundimi i restaurimit dhe rikualifikimi i hapësirës do ta shndërrojë atë në një nga atraksionet më të rëndësishme të turizmit historik në vend.



NOMADTECH – SHQIPËRIA, DESTINACION PËR NOMADËT DIXHITALË DHE QENDËR INOVACIONI RAJONAL



NomadTech është një dëshmi e qartë e transformimit të Shqipërisë në një destinacion të preferuar për nomadët dixhitalë dhe një qendër rajonale për inovacion. Përmes partneriteteve strategjike, politikave të zgjuara dhe një vizioni afatgjatë, po krijojmë një ekosistem që formon të ardhmen e ekonomisë sonë. Rruga është e gjatë, por ne ecim përpara me ambicie, guxim dhe besim në potencialin e jashtëzakonshëm që ka Shqipëria.

MUZEU “BESA” – DËSHMI E HUMANIZMIT SHQIPTAR

Rrugëtimi për realizimin e Muzeut "Besa" ka nisur. Ky muze do të jetë një dëshmi e rrallë e humanizmit të shqiptarëve, të cilët, gjatë Luftës së Dytë Botërore, sfiduan çdo rrezik për të strehuar, mjekuar dhe ushqyer hebrenjtë. Artefaktet e muzeut do të sjellin histori frymëzuese dhe krenari shqiptare. MEKI, me themelimin e Fondacionit “Besa”, ka nisur përgatitjet për realizimin e projektit të studios Arch Openheim, duke siguruar fondet dhe investimet për këtë vlerë të jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore.



NGA IDEJA TE NDIKIMI – KONFERENCA NË DITËN BOTËRORE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Ministri Blendi Gonxhja mori pjesë në konferencën e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, ku u diskutua roli thelbësor i inovacionit dhe mbrojtjes së ideve për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Strategjia Kombëtare 2025-2030 dhe hapja e negociatave me BE për Kapitullin e Pronësisë Intelektuale janë dëshmi e angazhimit për të ndërtuar një Shqipëri që krijon, mbron dhe eksporton dije. Falenderojmë partnerët vendas dhe ndërkombëtarë, veçanërisht Organizatën Evropiane të Patentave, për mbështetjen në këtë rrugëtim!



K'CIMI I TROPOJËS, TRASHËGIMI BOTËRORE NË SKENËN E TKOB



Në një mbrëmje magjike në TKOB, u kremtua përfshirja e K'cimit të Tropojës në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s, përmes një spektakli magjepsës me kostume tradicionale, ritme shpërthyese dhe kërcime që mishërojnë shpirtin e malësisë. Artistë, bartës të traditës ndër breza dhe Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore sollën në skenë një homazh të gjallë për trashëgiminë kulturore shqiptare, në një atmosferë të mbushur me emocione dhe krenari.

PREZANTIMI I RAPORTIT “SME POLICY INDEX 2026” PËR SHQIPËRINË



Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësuar nga Zëvendësministri Z. Sokol Duma, zhvilloi takimin prezantues të metodologjisë së raportit “SME Policy Index për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2026”, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi ciklin e ri të vlerësimit të politikave për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Ky dokument i hartuar nga OECD do të analizojë progresin e vendeve të rajonit, përfshirë Shqipërinë, në përputhje me objektivat e integritit evropian, si dhe do të ofrojë rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit. MEKI do të vijojë rolin e saj koordinues me institucionet përkatëse gjatë gjithë vitit 2025.

ZAN'ART – ARTIZANATI SHQIPTAR SI MOTOR I ZHVILLIMIT EKONOMIK



Eventi ZAN'ART dëshmoi qartë potencialin e artizanatit shqiptar për t'u kthyer në një burim të qëndrueshëm zhvillimi ekonomik. Nga punimet në dru, qelq, qëndisje e deri te filigrani e poçeria, u promovuan produktet "Made in Albania" dhe u krijua një hapësirë e rëndësishme dialogu mes artizanëve, institucioneve dhe partnerëve për politika të reja mbështetëse. Ky është një hap i parë drejt kthimit të trashëgimisë kulturore në një forcë të gjallë të ekonomisë shqiptare.